



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/28

Datë: 25/6/2024

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me qëllim të stimulimit dhe avancimit të fushës së botimeve për librat universitarë, në përputhje edhe me objektivat strategjike menaxheriale, bazuar në kushtet dhe kriteret e Rregullores për Publikime të Universitetit të Prishtinës nr. prot. 2/283, datë 3/10.2013. Në mbledhjen e mbajtur më 13.6.2024 mori këtë:

V E N D I M


- I. Aprovohen kriteret për thirrje për botimin e librave universitarë.
- II. Këshilli Drejtues i UP-së, duke e parë si interes për universitetin dhe stafin akademik të UP-së, aprovoi kriteret për thirrje për botimin e librave universitare, kriteret janë:
 - Pranohen dorëshkrime nga të gjitha fushat e studimeve shkencore dhe artistike. Përparësi botimi kanë dorëshkrimet, sidomos për lëndët mësimore që nuk kanë tekst bazë universitar në gjuhën shqipe dhe që me plane dhe programe mësimore janë literaturë bazë;
 - Tekstet duhet t'i përmbajnë arritjet profesionale, shkencore dhe artistike, në pajtim me kërkesat bashkëkohore metodologjike dhe pedagogjike;
 - Nuk pranohen dorëshkrime të teksteve të botuara më herët;
 - Autorë/bashkautorë të teksteve duhet të jenë personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune. Në raste të veçanta dhe në fusha specifike, autorë/bashkautorë të teksteve mund të jenë edhe stafi akademik i pensionuar i UP-së;
 - Paraprakisht, merret pëlqimi i këshillit të njësisë akademike, i cili, po ashtu, e miraton dorëshkrimin, bashkë me raportin e recensentëve;
 - Lejen dhe vendimin përfundimtar, në përputhje me kriteret dhe procedurat e rregullores në fuqi, e jep Këshilli Botues i UP-së;
 - Dorëshkrimi duhet t'i nënshtrohet recensionit të së paku tre anëtarëve të fushës përkatëse, të cilët i cakton këshilli i njësisë akademike. Dorëshkrimi duhet të ketë së paku dy vlerësime pozitive të recensentëve;
 - Dorëshkrimi duhet të jetë në pajtim me planin dhe programin mësimor për lëndën /lëndët përkatëse;
 - Dorëshkrimet duhet të jenë të lekturuara dhe të korrektuara;
 - Me rastin e aplikimit, autori-ja/bashkautorët duhet të nënshkruajnë deklaratë për origjinalitetin e punimit dhe përgjegjësitë e tjera;

- Një autor/e ka të drejtë të konkurrojë me vetëm një dorëshkrim brenda së njëjtës thirrje;
- Skema e kompensimit financiar për honorarët për autorët, redaktorin, recensentët, lekturë dhe korrekturë, si dhe kompensimit nga mjetet e grumbulluara nga shitja dizajnohet nga Këshilli Botues bazuar në nenin 13 të Rregullores për publikime e UP-së në fuqi;
- Shuma financiare e planifikuar për mbështetjen e botimeve për këtë vit është 80.000 euro, e cila do mund të rivlerësohet varësisht mundësive buxhetore;
- Dorëshkrimet, bashkë dokumentacionin tjetër siç kërkohet në formularin e aplikimit, në versionin e shtypur (lidhje e butë) dhe në versionin elektronik, duhet të dorëzohen në rektorat (zyra e protokollit), me mbishkrimin “Për Këshillin Botues”, më së largu deri më 31 tetor 2024.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi t’u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Këshillit Drejtues të UP-së,
3. Dekanëve të njësive akademike,
4. Sekretarëve të njësive akademike,
5. Zyrës për çështje akademike në UP,
6. Zyrës ligjore të UP-së,
7. Zyrtares administrative të KD-së



Këshilli Drejtues i UP-së

Albin Sahiti - kryesues